

Udhëzimi i Përkohshëm I_02_2005 mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë, për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006

Shtojca 2

Detajet për Llogaritjen e Tarifës

A. Tarifa për konsumatorët e pa-njehsuar

A.1 Në përputhje me Nenin 13, kriteri për ndarjen e konsumatorëve të pa-njehsuar në grupe tarifore, është kërkesa e ndryshme për ngrohje (konsumi) për metër katror. Parametrat kryesorë që përcaktojnë kërkesën për ngrohje të çdo grupi konsumatorësh janë:

- Kërkesa specifike për kapacitet ngrohës, që është kërkesë e llogaritur e kapacitetit ngrohës për metër katror (e përcaktuar si kërkesa e vlerësuar për ngarkesë maksimale për metër katror, për temperaturën e jashtme të përcaktuar) për çdo grup konsumatorësh;
- Orët nominale për ngarkesë të plotë për ngrohje, është bazuar në kërkesat e veçanta për sa i përket vazhdimësisë së furnizimit, dhe është llogaritur si raporti midis furnizimit vjetor të konsumatorëve me ngrohje dhe kapacitetit të kontraktuar të ngrohjes për çdo grup konsumatorësh; dhe
- Sipërfaqja totale e ngrohjes, që përfaqëson sipërfaqen totale të ngrohur për çdo grup konsumatorësh që aktualisht furnizohet me ngrohje (prej bazës së të dhënave të konsumatorëve)

A.2 Llogaritja e kërkesës për ngrohje të çdo grupi të konsumatorëve për tërë sezonin e ngrohjes, bëhet në bazë të formulës:

$$HDi = (CDspi \times Si \times LHi) : 10^6$$

Ku:

HDi	Kërkesa sezonale për ngrohje e një grupi të veçantë konsumatorësh	MWh
CDspi	Kërkesa specifik për kapacitet e një grupi të veçantë konsumatorësh	W / m ²
Si	Sipërfaqja totale për ngrohje e grupit të konsumatorëve të veçantë (prej bazës së të dhënave të konsumatorëve)	m ²

LHi	Orët nominale të ngarkesës së plotë të një grupi të veçantë konsumatorësh	h
i	Grupi i konsumatorëve	-

A.3 Kërkesa totale për ngrohje të të gjithë konsumatorëve llogaritet si shumë e kërkesës për ngrohje të çdo grupi konsumatorësh, sipas formulës:

$$HD_T = \sum_{i=1}^n HD_i$$

A.4 Për qëllim të llogaritjes së tarifave për çdo grup të konsumatorëve, kërkesa për ngrohje për secilin grup, shprehet si raporti midis kërkesës për ngrohje të një grupi të caktuar konsumatorësh, dhe kërkesës totale për ngrohje, sipas formulës:

$$HD_{iR} = HD_i : HD_T$$

Ku:

HD_{iR}	Raporti i kërkesës për ngrohje për një grup të veçantë konsumatorësh	-
HD_T	Kërkesa totale për ngrohje e të gjithë konsumatorëve	MWh

A.5 Të ardhurat vjetore të lejuara për një grup të veçantë llogariten sipas formulës:

$$R_i = R \times HD_{iR}$$

A.6 Konsekuent me ndarjen e të ardhurave vjetore të lejuara në komponentin fiks dhe variabil, sipas Nenit 14.2, pjesëmarrja e çdo grupi konsumatorësh në të ardhurat vjetore të lejueshme të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore, është e përcaktuar sipas formulës:

$$R_{iF} = R_F \times HD_{iR}$$

dhe

$$R_{iV} = R_V \times HD_{iR}$$

A.7 Tarifa totale e ngrohjes për tërë sezonin për konsumatorët e pa-njehsuar, përbëhet nga 2 përbërës:

- 1) Tarifa e kapacitetit të kontraktuar të ngrohjes (komponenti fiks) - **Ty_{iHC}**
- 2) Tarifa e ngrohjes së dërguar (komponenti variabil) - **Ty_{iHD}**

A.8 Tarifa e kapacitetit ngrohës të kontraktuar për tërë sezonin (komponenti fiks) do të llogaritet bazuar në formulën:

$$T_{i_{HC}} = R_{i_F} : S_i$$

Ku:

T_{i_{HC}}	Tarifa sezonale e kapacitetit ngrohës të kontraktuar për grupin e konsumatorëve të veçantë	€/ m ²
R_{i_F}	Komponenti fiks i të ardhurave vjetore të lejuara për grupin e veçantë të konsumatorëve	€
S_i	Sipërfaqja totale për ngrohje e grupit të konsumatorëve të veçantë (prej bazës së të dhënave të konsumatorëve)	m ²

- A.9 Tarifa e ngrohjes së dërguar për tërë sezonin (komponenti variabil), do të llogaritet në bazë të formulës:

$$T_{i_{HD}} = R_{i_V} : S_i$$

Ku:

T_{i_{HD}}	Tarifa sezonale e ngrohjes së dërguar për grupin e veçantë të konsumatorëve	€/ m ²
R_{i_V}	Komponenti variabil i të ardhurave vjetore të lejuara për grupin e veçantë të konsumatorëve	€
S_i	Sipërfaqja totale për ngrohje e grupit të veçantë të konsumatorëve (prej bazës së të dhënave të konsumatorëve)	m ²

- A.10 Tarifa mujore përfaqëson tarifën sezonale të ndarë në gjashtë rata mujore (kohëzgjatja e sezonit ngrohës) dhe llogaritet sipas formulave vijuese:

- a) Tarifa mujore e kapacitetit ngrohës të kontraktuar (komponenti fiks) për grupin e veçantë të konsumatorëve:

$$T_{m_{i_{HC}}} = T_{i_{HC}} : 6$$

- b) Tarifa mujore e ngrohjes së dërguar (komponenti variabil) për një grup të veçantë konsumatorësh:

$$T_{m_{i_{HD}}} = T_{i_{HD}} : 6$$

B Tarifa për Konsumatorët e Njehsuar

B.1 Tarifa totale e ngrohjes për tërë sezonin për konsumatorët e njehsuar, përbëhet nga 2 komponentë:

- 1) Tarifa e kapacitetit të kontraktuar të ngrohjes (komponenti fiks) - $T_{y_{HC}}$
- 2) Tarifa e ngrohjes së dërguar (komponenti variabil) - $T_{y_{HD}}$

B.2 Tarifa e kapacitetit total të kontraktuar të ngrohjes për tërë sezonin (komponenti fiks) do të llogaritet bazuar në formulën:

$$T_{y_{HC}} = R_F : N$$

Ku:

$T_{y_{HC}}$	Tarifa sezonale e kapacitetit ngrohës të kontraktuar	€/ kW
R_F	Komponenti fiks i të ardhurave vjetore të lejuara	€
N	Kapaciteti total ngrohës i kontraktuar (prej bazës së të dhënave të konsumatorëve)	kW

B.3 Tarifa e ngrohjes së dërguar për tërë sezonin (komponenti variabil), do të llogaritet në bazë të formulës:

$$T_{y_{HD}} = R_V : Q$$

Ku:

$T_{y_{HD}}$	Tarifa sezonale e ngrohjes së dërguar	€/ kWh
R_V	Komponenti variabil i të ardhurave vjetore të lejuara	€
Q	Sasia totale e ngrohjes që vlerësohet se do ti dërgohet konsumatorëve gjatë tërë sezonit të ngrohjes	kWh

B.4 Tarifat mujore përfaqësojnë tarifat sezonale të ndara në gjashtë rata mujore (kohëzgjatja e sezonit ngrohës) dhe llogariten sipas formulave vijuese:

a) Tarifa mujore e kapacitetit ngrohës të kontraktuar (komponenti fiks):

$$T_{m_{HC}} = T_{y_{HC}} : 6$$

b) Tarifa mujore e ngrohjes së dërguar (komponenti variabil) është e njëjtë me tarifën sezonale $T_{y_{HD}}$ e llogaritur sipas pikës B.3.